


Integriteti akademik, publikimi shkencor dhe justifikimi i titujve akademikë në Universitetin e Prishtinës

PRISHTINË, PRILL 2021



Integriteti akademik, publikimi shkencor dhe justifikimi i titujve akademikë në Universitetin e Prishtinës

PRISHTINË, PRILL 2021

Publikues:

ORCA - Organizata për Rritjen e Cilësisë në Arsim

www.orca-ks.org

info@orca-ks.org

Rruga Henrik Bariç, nr. 6
Prishtina, 10000, Kosova

Hulumtues:

Adea Kondirolli
Gramos Buçinca
Saranda Sylejmani

Autor:

Adea Kondirolli

Dizajn dhe Layout:

Envinion

Prishtinë, prill 2021



“Ati ynë që je në qiell, jepna fuqinë ta mbajmë
gojën mbyllur kur s’kemi gjë për të thënë.
Falna durimin të thellojmë një punë përpara
se të shkruajmë mbi të! Frymëzoni me një
ndjenë të mprehtë të drejtësisë që të flasim jo
vetëm me paanësi, por edhe të sillemi ashtu!
Shpëtona nga grackat e gramatikës, nga
shtrembërimet e gjuhës dhe nga lajthitjet e
shtypit. Ashtu qoftë!”

[Faik Konica]

PËRMBAJTJA

DEFINIME	7
HYRJE	8
PASQYRA AKADEMIKE E UP-SË	11
Numri i publikimeve shkencore në Universitetin e Prishtinës	12
Mesatarja e punimeve për profesor	14
Analiza moshore dhe gjinore e profesorëve pa asnjë punim shkencor ..	16
Borxhi Akademik	19
Publikimi në revista të dyshimta.....	21
Justifikimi i titujve akademikë	23
Justifikimi i titujve i zbërthyer në gjini.....	26
Justifikimi i titujve i zbërthyer në grupmosha	29
PASQYRA AKADEMIKE PËR FAKULTETE	31
Fakulteti Ekonomik	33
Fakulteti Filozofik	38
Fakulteti i Arkitekturës	44
Fakulteti i Bujqësisë dhe i Veterinarisë	49
Fakulteti i Edukimit	55
Fakulteti i Edukimit Fizik dhe i Sportit.....	61
Fakulteti i Filologjisë.....	66
Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike	71
Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike.....	76
Fakulteti i Mjekësisë.....	82
Fakulteti i Ndërtimtarisë	87
Fakulteti i Shkencave Matematike - Natyrore	91
Fakulteti Juridik.....	97
METODOLOGJIA.....	102

DEFINIME

- **Punime me koeficient** - konsiderohen punimet e publikuara në revista siç është përcaktuar me ligjet dhe rregullativat në fuqi.
- **Pjesëmarrje në punime** - punimet ku profesorët marrin pjesë si autorë pavarësisht renditjes, pra jo vetëm si autor i parë apo korrespondent.
- **Punime në revista të dyshimta** - punimet të cilat janë në revista apo në botues të listuar në listën Beall.
- **Justifikimi i titullit** - të pasurit e numrit të nevojshëm të publikimeve shkencore për titullin përkatës sipas ligjeve dhe rregullativave në fuqi.
- **Burra dhe gra** - Dy gjini të presupozuara të personave në bazë të emrave pa paragjykuar identifikimin e tyre personal.

ÇKA PO BËJMË NE?

Parathënie nga Rron Gjinovci, Drejtor i ORCA

Është kënaqësi, që pas 4 vjetësh monitorim, kritika publike, publikime raportesh, protesta, mospajtime, bashkëpunime, të gjitha këto që ndodhën mes nesh - si aktivistë të arsimit dhe menaxhmentit të Universitetit të Prishtinës, sot të sjellim para publikut rezultatin e prekshëm, të matshëm dhe domethënës të të gjithë marrëdhënies sonë.

Për herë të parë prej se bëhen matje e ndoshta edhe në historinë e tij, Universiteti i Prishtinës ka më shumë profesorë që justifikojnë titujt akademikë sesa e kundërta. Në vitin 2017 ishim të tronditur me rezultatet e hulumtimit tonë. 72% të profesorëve të tij nuk kishin punime mjaftueshëm për t'i justifikuar titujt e tyre (gjithmonë, kur flasim për justifikim, ne në ORCA fjalën e kemi për kriterin e punimeve shkencore). Sot kjo përqindje ka rënë në 45%. Kjo ka ndodhur në saje të rritjes së numrit të publikimeve shkencore në mënyrë jashtëzakonisht të shpejtë në 3 vitet e fundit, ku një e treta e të gjitha punimeve të profesorëve aktualë të Universitetit, që prej vitit 1988 kur kemi identifikuar punimin e parë, janë të tre viteve të fundit. Prej 15 shkurtit 2017 kur publikuam raportin e parë dhe me ç'rast filloi debati konkret për cilësinë e mësimdhënësve në universitetin më të mirë e më të madh në vend, grafet tregojnë dyfishim nga viti në vit të publikimeve shkencore.

Për 3 vite me radhë monitorimi i procesit të avancimeve që ka shkuar me ato që një Komision Zgjedhor do t'i quante “incidente të izoluar”, ka treguar se avancimi jomeritor është zhdukur si formë e operimit në Universitetin e Prishtinës. Monitorimi nga ana jonë u fuqizua edhe nga mediet që gjithnjë patën disponim t'i përcjellin ngjarjet tona, deri kohëve të fundit kur një gjë e tillë ka filluar të mos ndodhë. Interesimi i medieve për gjetjen e “skandalit” me qëllim të rritjes së klikimeve dhe mosinteresimi i tyre në arsim në përgjithësi si një temë jo dhe aq e nxehtë, ka bërë që edhe metodat tona për arritje te publiku të avancohen.

Prej ditës së parë të kritikës publike e deri më sot ende vazhdon debati për pyetjen “Kush jeni ju me na kontrollu neve?”. Kësaj pyetje i jemi përgjigjur shpesh e si rrjedhojë debate të reja kanë lindur. Këmbëngulësia jonë në adresimin e çështjes dhe konsistenca metodologjike, siç duket e kanë zbehur fuqinë e atyre që shërbeheshin me këtë pyetje. Tashmë të gjithë janë bindur se për arsye të caktuara neve na takon ta bëjmë atë që bëjmë, ndonëse shumë palë që e pranojnë këtë gjë publikisht mund të mos jenë të bindura në veten e tyre. E ne, të mbetur pa sfidë kemi filluar ta shtrojmë pyetje për veten tonë, “Çka po bëjmë ne?”.

Si hulumtues kemi parë se rregullat e imponuara nga Ministria e Arsimit, të përcjella me një sërë dokumentesh tjera nga vet universitetet, që kanë marrë për bazë rekomandimet tona, kanë krijuar shtigje të reja për keqpërdoruesit, që për fatin e keq të vendit tonë, janë të shumtë, mbajnë tituj akademikë, grada shkencore e çmime meritash. Mbajnë apo mbanin edhe poste të larta politike.

Çka po bëjmë ne? A mos vallë duke u bërë si polic kemi krijuar nëntokën akademike? Çfarë duhet të bëjmë ne që mashtruesit të mos mund të na i tundin fytyrës “sukseset” e tyre sipas kriterëve të cilat me fanatizëm i mbrojmë e i promovojmë ne? Për këto dhe shumë pyetje të tjera, kolektivi i ORCA-s dhe miqve të saj bënë debat të zjarrtë brenda vetes, me pasionin e atyre që angazhohen për drejtësi e barazi shoqërore. Prandaj, ne jemi të vetëdijshëm për defektet që proceset i kanë, thjesht po mundohemi t’i identifikojmë zgjidhjet më të mira për to.

Shumë shpejt ORCA do të zgjerojë gamën e instrumenteve që do ta përdorë për të luftuar cënimin e integritetit akademik. Shumë shpejt do të kalojmë në transformimin e nevojshëm metodologjik e përmbajtësor për t’i dhënë një dimension të ri luftës për integritet akademik në Kosovë, luftës për rritjen e cilësisë së arsimit në vendin mbarë. Shumë shpejt skeptikët e punës sonë do ta kenë mundësinë edhe njëherë ta rimendojnë pozicionin e tyre për neve dhe të binden se limitet e luftës sonë nuk ndodhin për shkak të mungesës së vullnetit tonë, por për shkak të rrethanave e kushteve, mbingarkesës me urgjenca që në vendin tonë nga mëngjesi në darkë nuk përfundojnë pothuajse në asnjë situatë të asnjë institucioni të arsimit. Shumë shpejt do të mund të rigrupohemi e ripozicionohemi në betejat e reja të luftës e cila pa më të voglin dyshim, do të jetë tepër e gjatë, luftës për cilësi në arsim.

PASQYRA AKADEMIKE E UP-SË



PASQYRA AKADEMIKE E UP-SË

Universiteti i Prishtinës ka 509 profesorë që mund të evidentohen në faqen e Universitetit, 360 (71%) prej të cilëve janë burra dhe 149 (29%) janë gra. 206 (40.5%) janë profesorë asistentë, 155 (30.5%) janë profesorë të asocuar dhe 148 (29%) profesorë të rregullt. Nga 206 profesorë asistentë, 78 janë gra (37%) e 128 janë burra. Nga 155 profesorë të asocuar 48 janë gra (31%) e 107 janë burra. Nga 148 profesorë të rregullt, vetëm 23 janë gra (15%) e 125 janë burra.

Mosha mesatare e profesorëve në Universitetin e Prishtinës është 51.47 vjeç. Te profesoret gra mosha mesatare është 48, ndërsa te burrat është 53. Te profesorët e rregullt mosha mesatare është 57, te profesorët e asocuar është 52, dhe te profesorët asistentë është 46 vjeç. Mes profesorëve që justifikojnë titujt e tyre, mosha mesatare është 48 vjeç, ndërsa ata që nuk e justifikojnë kanë mesatarisht 56 vjet.

NUMRI I PUBLIKIMEVE SHKENCORE NË UNIVERSITETIN E PRISHTINËS

Nga profesorët që kanë publikuar CV-të e tyre në faqen e Universitetit evidentohen si punime të vlefshme për avancim akademik – pra si autor i parë apo korrespondent, gjithsej 1838 punime. Një rritje domethënëse prej 369 punimesh në krahasim me vitin 2019 kur ishin evidentuar 1469 punime, dhe një diferencë prej 1091 sosh në krahasim me 2017 kur ishin evidentuar 747 punime, kur dhe ka filluar ky hulumtim. Nga viti 2017 deri në vitin 2020 mund të thuhet se numri i punimeve që evidentohen si të vlefshme për avancime akademik është rritur për gati 150%. Në këtë rritje ka luajtur rol presioni për përditësimin e CV-ve, ku një numër i punimeve të pa evidentuara më parë janë shtuar ndërkohë, dhe punësimi i stafit të ri të cilët e kanë pasur të nevojshme publikimin shkencor për punësim. Pra ky numër nuk e paraqet numrin e punimeve të publikuara në këtë periudhë (2017-2020), por që janë evidentuar si të vlefshme për avancime akademike përgjatë viteve 2017-2020.


Ndërkaq, numri i punimeve të llogaritura ku kanë marrë pjesë edhe profesorët që nuk janë autor i parë apo korrespondent për vitin 2020, është 2564. Kjo shifër paraqet një rritje prej 522 punimesh nga 2042 sa ishin evidentuar në vitin 2019; dhe një rritje prej 1244 punimesh nga 1320 sa ishin në vitin 2017. Ndërsa, nga viti 2017 (kur dhe ka filluar kjo matje) deri në vitin 2020 janë publikuar 939 punime në revista shkencore, që paraqet 37% të numrit total të punimeve të evidentuara në UP që nga viti 1988.

Viti 2017 shënon vitin me më së shumti punime të llogaritura ku kanë marrë pjesë edhe profesorët që nuk janë autor i parë apo korrespondent, me 323 sosh që nga viti 1988 kur është regjistruar publikimi i parë i tillë.

29% (150 nga 509) e profesorëve nuk kanë asnjë punim shkencor të listuar në CV. Ndonëse e dhënë shumë shqetësuese, kjo paraqet një përmirësim nga viti 2019 kur ishte 39%, 2018 kur ishte 45%, dhe 2017 kur ishte 44%.

Një e treta (34%) e profesorëve mbi moshën 50 vjeçare (91 nga 265) nuk kanë asnjë punim shkencor të listuar në CV-të e tyre. Në vitin 2019, 48% e profesorëve mbi moshën 50 vjeçare nuk kishin asnjë punim. Po ashtu 31% e profesorëve burra (114 nga 360) nuk kanë asnjë punim shkencor të listuar në CV-të e tyre, ndërsa 24% e grave (36 nga 149) nuk kanë asnjë punim shkencor të listuar në CV-të e tyre.

Numri i publikimeve në Universitetin e Prishtinës



MESATARJA E PUNIMEVE PËR PROFESOR

Mesatarja e punimeve shkencore për profesor në UP është 5. Duke pasur parasysh që 150 profesorë nuk kanë fare punime shkencore, mesatarja e punimeve për profesor mes atyre që kanë publikuar të paktën një punim do të dilte 7 punime për profesor.

Fakulteti me mesataren më të lartë të punimeve për profesor është Fakulteti i Shkencave Matematike Natyrore me 9.06 punime për profesor. Ndërkaq, nga shkencat shoqërore mesataren më të lartë vazhdon ta ketë Fakulteti i Edukimit me 4 punime për profesor.

Fakulteti me më së paku punime në Universitetin e Prishtinës është Fakulteti i Ndërtimitarisë me 1.79 punime për profesor.

Fakulteti me më së shumti punime shkencore është Fakulteti i Mjekësisë me gjithsej 681. Fakulteti me më së paku punime shkencore është Fakulteti i Arkitekturës me gjithsej 21.

Profesorët e shkencave shoqërore, për nga numri i publikimeve shkencore mbesin shumë më mbrapa kolegëve të tyre nga shkencat ekzakte.

PUBLIKIMET SHKENCORE PËR PROFESOR

Nr.	Fakultetet në Universitetin e Prishtinës	Nr. i publikimeve	Nr. i profesorëve	Punime unike për profesor
1	Fakulteti Ekonomik	159	43	3.70
2	Fakulteti Filozofik	92	42	2.19
3	Fakulteti i Arkitekturës	21	8	2.63
4	Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë	277	40	6.93
5	Fakulteti i Edukimit	146	36	4.06
6	Fakulteti i Edukimit Fizik dhe i Sportit	29	15	1.93
7	Fakulteti i Filologjisë	169	50	3.38
8	Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike	86	23	3.74
9	Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike	140	27	5.19
10	Fakulteti i Mjekësisë	681	96	7.09
11	Fakulteti i Ndërtimtarisë	34	19	1.79
12	Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore	625	69	9.06
13	Fakulteti Juridik	105	41	2.56
Total 2020		2564	509	5.04
Total 2019		2042	479	4.26
Total 2018		1735	465	3.73
Total 2017		1320	481	2.74

ANALIZA MOSHORE DHE GJINORE E PROFESORËVE PA ASNJË PUNIM SHKENCOR

Nga 150 profesorë pa asnjë punim shkencor, 91 janë mbi moshën 50 vjeçare, 17 janë të moshës 40 deri 50 vjeçare dhe vetëm 7 të moshës nën 40 vjeçare. Tri fakultetet me më së shumti profesorë pa asnjë punim shkencor janë ai i Mjekësisë (29), i Juridikut (17) dhe i Ekonomikut (16). Tri fakultetet me më së paku profesorë pa asnjë punim shkencor janë ai i Arkitekturës (1), i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike (5), Shkencave Matematike-Natyrore (7), dhe i Inxhinierisë Mekanike (8).

Tri fakultetet me përqindjen më të madhe të profesorëve pa asnjë punim shkencor janë ai i Edukimit Fizik dhe i Sportit (67%), i Ndërtimtarisë (53%) dhe i Juridikut (41%). Tri fakultetet me përqindjen më të ulët të profesorëve pa asnjë punim shkencor janë ai i Shkencave Matematike-Natyrore (10%), i Arkitekturës (13%), dhe i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike (22%).

NUMRI I PROFESORËVE PA ASNJË PUNIM SHKENCOR,
I ZBËRTHYER SIPAS GRUPMOSHËS

Nr.	Fakultetet në Universitetin e Prishtinës	NËN 40	40 DERI 50	MBI 50	E paverifikueshme	Totali i profesorëve pa asnjë punim shkencor	Totali i profesorëve në fakultet
1	Fakulteti Ekonomik	2	2	10	2	16	43
2	Fakulteti Filozofik	0	0	8	5	13	42
3	Fakulteti i Arkitekturës	0	0	1	0	1	8
4	Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë	0	2	6	2	10	40
5	Fakulteti i Edukimit	2	3	7	0	12	36
6	Fakulteti i Edukimit Fizik dhe i Sportit	0	1	7	2	10	15
7	Fakulteti i Filologjisë	0	2	8	2	12	50
8	Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike	0	0	5	0	5	23
9	Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike	0	0	7	1	8	27
10	Fakulteti i Mjekësisë	0	1	15	13	29	96
11	Fakulteti i Ndërtimtarisë	0	2	8	0	10	19
12	Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore	1	3	3	0	7	69
13	Fakulteti Juridik	2	1	6	8	17	41
Totali i zbërthyer në grupmoshë		7	17	91	35	150	509

Nga 150 profesorë pa asnjë punim shkencor vetëm 36 (24%) janë gra, ndërsa 114 (76%) janë burra. Brenda gjinisë së tyre del se 24% e grave janë pa asnjë punim shkencor, ndërsa 31% e burrave janë pa asnjë punim shkencor.

Nga shifrat e nxjerra sipas fakulteteve është e qartë se kur vjen puna te avancimi akademik, ndaj grave ka zbatim më rigoroz të rregullave sesa ndaj burrave, çka përbën një formë të avancuar të diskriminimit gjinor.

NUMRI I PROFESORËVE PA ASNJË PUNIM SHKENCOR I NDARË SIPAS GJINISË

Nr.	Fakultetet në Universitetin e Prishtinës	Gra	Burra
1	Fakulteti Ekonomik	4	12
2	Fakulteti Filozofik	1	12
3	Fakulteti i Arkitekturës	0	1
4	Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë	2	8
5	Fakulteti i Edukimit	7	5
6	Fakulteti i Edukimit Fizik dhe i Sportit	0	10
7	Fakulteti i Filologjisë	3	9
8	Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike	1	4
9	Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike	0	8
10	Fakulteti i Mjekësisë	12	17
11	Fakulteti i Ndërtimtarisë	1	9
12	Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore	1	6
13	Fakulteti Juridik	4	13
Totali		36 (24%)	114 (76%)

BORXHI AKADEMIK

Përtej profesorëve pa asnjë punim shkencor (150 profesorë), janë edhe 77 profesorë të tjerë që nuk justifikojnë titullin e tyre akademik (në total 227 profesorë nuk justifikojnë titujt e tyre). Këta të gjithë së bashku i kanë borxh Universitetit të Prishtinës 563 punime. Profesoret gra që nuk justifikojnë titujt (49 sosh), i kanë borxh Universitetit edhe 92 punime për të justifikuar titujt e tyre, apo përkthyer ndryshe ato duhet të botojnë nga 1.88 punime. Ndërsa profesorët burra që nuk justifikojnë titujt (178 sosh), i kanë borxh universitetit edhe 471 punime, apo nga 2.65 punime për profesor.

Fakulteti që ka më shumë borxh për kokë profesori është Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike ku 9 profesorë burra kanë borxh 29 punime, apo 3.22 punime për person. Ndërsa fakulteti që ka më pak borxh është ai i Arkitekturës, ku 3 profesorë duhet të botojnë nga një punim secili për të justifikuar titujt e tyre.

NUMRI I PUNIMEVE BORXH NDAJ UNIVERSITETIT
NGA PROFESORËT E SECILIT FAKULTET

Nr.	Fakultetet në Universitetin e Prishtinës	Gra	Burra
1	Fakulteti Ekonomik	11	59
2	Fakulteti Filozofik	1	47
3	Fakulteti i Arkitekturës	2	1
4	Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë	4	45
5	Fakulteti i Edukimit	11	18
6	Fakulteti i Edukimit Fizik dhe i Sportit	0	33
7	Fakulteti i Filologjisë	6	50
8	Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike	4	14
9	Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike	0	29
10	Fakulteti i Mjekësisë	32	62
11	Fakulteti i Ndërtimtarisë	3	19
12	Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore	3	44
13	Fakulteti Juridik	15	50
Total punime borxh ndaj universitetit		92	471
Mesatarja e punimeve borxh për kokë profesori që nuk justifikon titullin		1.88	2.65

PUBLIKIMI NË REVISTA TË DYSHIMTA

191 profesorë kanë botuar 672 punime në revista të dyshimta. Në vitin 2019 kanë qenë 152 profesorë me 532 punime, në vitin 2018 ishin 502 punime të tilla nga 153 profesorë. Numri i publikimeve në revista të dyshimta është në rënie nga viti 2018 e tutje, por për shkak të punësimit të stafit të ri dhe përditësimit të CV-ve nga stafi akademik (me punime të botuara më parë) është shtuar numri total i punimeve në revista të dyshimta. Si botime të reja, në vitin 2018 ka pasur 26 punime të tilla, në vitin 2019 shtatë, dhe në vitin 2020 tetë.

Nga 191 profesorë që kanë botuar në revista të dyshimta, 135 (71%) janë burra, dhe 56 (29%) janë gra. Është e evidente se në të gjitha fakultetet gratë janë më të vëmendshme në ruajtjen e integritetit akademik sesa burrat.

Profesorët e FSHMN kanë publikuar më së shumti në revista të dyshimta, gjithsej 238 punime nga 42 profesorë. Një nga arsyt pse ky fakultet ka botuar më së shumti në revista të dyshimta, është për shkak të numrit të lartë të prodhimit shkencor në këtë fakultet. Në FShMN janë 625 punime në revista shkencore të mirëfillta, dhe nëse i llogarisim në kuadër të punimeve totale, punimet në revista të dyshimta paraqesin 28% të punimeve totale, pra të dyshimta dhe të mirëfillta.

Fakulteti me marzhën më të ultë të botimeve në revista të dyshimta karshi atyre të mirëfillta, është Fakulteti i Filologjisë me 14 punime në revista të dyshimta (apo 8%) përkundër 169 punimeve në revista shkencore.

Fakulteti me marzhën më të lartë të punimeve në revista të dyshimta karshi atyre në revista shkencore është Fakulteti i Ndërtimitarisë me 23 punime në revista të dyshimta (apo 40%) përkundër 34 punimeve në revista shkencore.




PUBLIKIMET NË REVISTA TË DYSHIMTA

Nr.	Fakultetet në Universitetin e Prishtinës	Numri i punimeve	Numri i profesorëve	Profesorët burra që kanë publikuar në revista të dyshimta	Profesorët gra që kanë publikuar në revista të dyshimta
1	Fakulteti Ekonomik	60	19	11	8
2	Fakulteti Filozofik	10	7	5	2
3	Fakulteti i Arkitekturës	3	1	0	1
4	Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë	48	19	17	2
5	Fakulteti i Edukimit	40	19	9	10
6	Fakulteti i Edukimit Fizik dhe i Sportit	10	4	4	0
7	Fakulteti i Filologjisë	14	4	2	2
8	Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike	26	13	10	3
9	Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike	23	12	11	1
10	Fakulteti i Mjekësisë	149	41	23	18
11	Fakulteti i Ndërtimtarisë	23	5	5	0
12	Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore	238	42	34	8
13	Fakulteti Juridik	28	5	4	1
TOTALI 2020		672	191	135	56
Totali 2019		532	152	101	51
Totali 2018		502	153	n.a	n.a
Totali 2017		352	137	n.a	n.a

Viti 2015 ka më së shumti punime në revista të dyshimta me gjithsej 117. Ndërkaq nga viti 2017 shihet rënie drastike e publikimeve të tilla. Në shkurt të vitit 2017 ORCA pati publikuar raportin e parë të saj për integritetin akademik.

Publikimi në revista të dyshimta në Universitetin e Prishtinës



JUSTIFIKIMI I TITUJVE AKADEMIKË

Në vitin 2020, 45% (227 nga 509) e profesorëve në UP nuk i justifikojnë titujt e tyre akademikë. Ndonëse ky është një përmirësim nga vitet e kaluara kur përqindja ishte 72% në vitin 2017, 59% në vitin 2018, dhe 55% në vitin 2019, gjendja mbetet e rëndë.

Sa më i lartë titulli akademik, aq më e madhe mundësia që profesori nuk e justifikon titullin akademik. 86 nga 148 profesorë të rregullt (58%) nuk e justifikojnë titullin e tyre akademik, 69 nga 155 profesorë të asocuar (45%) nuk e justifikojnë titullin e tyre akademik dhe 72 nga 206 profesorë asistentë (35%) nuk e justifikojnë titullin e tyre akademik.

Shprehur në përqindje del se 58% e profesorëve të rregullt nuk e justifikojnë titullin e tyre akademik, ndërkaq në 2019 përqindja ishte 66%, në 2018 ishte 76%, kurse në 2017 ishte 87%.


45% e profesorëve të asocuar nuk e justifikojnë titullin akademik, ndërkaq në 2019 ishin 60%, në 2018 ishin 65%, kurse në 2017 ishin 79%.

35% e profesorëve asistentë nuk e justifikojnë titullin akademik, në 2019 dhe 2018 ishin 40% të tillë, kurse në 2017 ishin 51%.

Për justifikimin e të gjithë titujve të evidentuar do të duheshin publikuar edhe 563 punime shkencore, çka paraqet edhe “borxhin akademik” që këta profesorë ia kanë Universitetit të Prishtinës.

Në këtë rezultat, sidomos te grupmosha më e re, ka ndikuar monitorimi i procesit të avancimeve akademike për të cilin mund të konstatohet se që nga viti 2017 kur ka filluar ky monitorim dhe sidomos nga viti 2018 kur është futur në fuqi udhëzimi administrativ që përcakton platformat indeksuese, nuk është shënuar asnjë rast i avancimeve pa justifikim formal të titullit akademik, çka nuk ishte praktikë para vitit 2017 kur ORCA kishte publikuar raportin e parë të saj lidhur me çështjen në fjalë.

JUSTIFIKIMI I TITUJVE AKADEMIKË



JUSTIFIKIMI I TITUJVE

Nr.	Fakultetet në Universitetin e Prishtinës	Profesorët asistentë		Profesorët e asocuar		Profesorët e rregullt	
		✓	✗	✓	✗	✓	✗
1	Fakulteti Ekonomik	0	8	11	6	6	12
2	Fakulteti Filozofik	18	4	6	6	2	6
3	Fakulteti i Arkitekturës	4	1	1	1	0	1
4	Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë	11	3	6	7	5	8
5	Fakulteti i Edukimit	14	10	4	4	1	3
6	Fakulteti i Edukimit Fizik dhe i Sportit	2	3	1	6	0	3
7	Fakulteti i Filologjisë	13	4	9	13	6	5
8	Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike	5	3	9	1	2	3
9	Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike	5	3	3	0	10	6
10	Fakulteti i Mjekësisë	32	14	17	11	7	15
11	Fakulteti i Ndërtimtarisë	3	7	2	4	1	2
12	Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore	18	5	14	7	15	10
13	Fakulteti Juridik	9	7	3	3	7	12
TOTALI PËR TITULL 2020		134 (65%)	72 (35%)	86 (55%)	69 (45%)	62 (42%)	86 (58%)
Totali për titull 2019		104 (60%)	70 (40%)	63 (40%)	93 (60%)	50 (34%)	99 (66%)
Totali për titull 2018		98 (60%)	64 (40%)	58 (35%)	107 (65%)	33 (24%)	105 (76%)
Totali për titull 2017		80 (49%)	84 (51%)	37 (21%)	140 (79%)	18 (13%)	122 (87%)

Justifikimi i titujve i zbërthyer në gjini

UP ka 149 gra dhe 360 burra si profesorë me tituj akademikë. 33% (49 nga 149) e grave nuk e justifikojnë titullin e tyre, krahasuar me 49% (178 nga 360) të burrave. Në gjysmën e fakulteteve numri i burrave që nuk e justifikojnë titullin është më i madh sesa i atyre që e justifikojnë titullin, ndërkohë që në shumicën e fakulteteve më shumë gra e justifikojnë titullin se që nuk e justifikojnë, përvec në Fakultetin Juridik.

JUSTIFIKIMI I TITUJVE SIPAS GJINISË

Nr.	Fakultetet në Universitetin e Prishtinës	PROFESORËT GRA		PROFESORËT BURRA	
		✓	⊖	✓	⊖
1	Fakulteti Ekonomik	8	6	9	20
2	Fakulteti Filozofik	9	1	17	15
3	Fakulteti i Arkitekturës	5	2	0	1
4	Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë	2	2	20	16
5	Fakulteti i Edukimit	11	8	8	9
6	Fakulteti i Edukimit Fizik dhe i Sportit	1	0	2	12
7	Fakulteti i Filologjisë	15	4	13	18
8	Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike	6	2	10	5
9	Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike	2	0	16	9
10	Fakulteti i Mjekësisë	29	16	27	24
11	Fakulteti i Ndërtimtarisë	1	1	5	12
12	Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore	9	2	38	20
13	Fakulteti Juridik	2	5	17	17
Totali i zbërthyer në gjini		100 (67%)	49 (33%)	182 (51%)	178 (49%)

Te profesorët gra, 70% e justifikojnë titullin profesor asistent, 69% e justifikojnë titullin profesor i asocuar dhe 52% titullin profesor i rregullt.

JUSTIFIKIMI I TITUJVE TE PROFESORËT GRA

Titujt	Profesorë Asistent		Profesorë të Asocuar		Profesorë të Rregullt	
	✓	✗	✓	✗	✓	✗
Fakultetet	✓	✗	✓	✗	✓	✗
Fakulteti Ekonomik	0	3	5	1	3	2
Fakulteti Filozofik	7	1	2	0	0	0
Fakulteti i Arkitekturës	4	0	1	1	0	1
Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë	2	1	0	1	0	0
Fakulteti i Edukimit	9	6	1	2	1	0
Fakulteti i Edukimit Fizik dhe i Sportit	1	0	0	0	0	0
Fakulteti i Filologjisë	6	2	7	2	2	0
Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike	2	1	4	0	0	1
Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike	1	0	1	0	0	0
Fakulteti i Mjekësisë	19	8	7	3	3	5
Fakulteti i Ndërtimtarisë	0	0	1	1	0	0
Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore	3	1	4	1	2	0
Fakulteti Juridik	1	0	0	3	1	2
Total	55 (70%)	23 (30%)	33 (69%)	15 (31%)	12 (52%)	11 (48%)

Te profesorët burra, 62% e justifikojnë titullin profesor asistent, 49% e justifikojnë titullin profesor i asocuar dhe 40% titullin profesor i rregullt. Në krahasim me profesorët gra, justifikimi i secilit titull te profesorët burra është më i vogël.

JUSTIFIKIMI I TITUJVE TE PROFESORËT BURRA

Titujt	Profesorë Asistent		Profesorë të Asocuar		Profesorë të Rregullt	
	✓	✗	✓	✗	✓	✗
Fakultetet	✓	✗	✓	✗	✓	✗
Fakulteti Ekonomik	0	5	6	5	3	10
Fakulteti Filozofik	11	3	4	6	2	6
Fakulteti i Arkitekturës	0	1	0	0	0	0
Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë	9	2	6	6	5	8
Fakulteti i Edukimit	5	4	3	2	0	3
Fakulteti i Edukimit Fizik dhe i Sportit	1	3	1	6	0	3
Fakulteti i Filologjisë	7	2	2	11	4	5
Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike	3	2	5	1	2	2
Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike	4	3	2	0	10	6
Fakulteti i Mjekësisë	13	6	10	8	4	10
Fakulteti i Ndërtimtarisë	3	7	1	3	1	2
Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore	15	4	10	6	13	10
Fakulteti Juridik	8	7	3	0	6	10
Totali (përqindjet)	79 (62%)	49 (38%)	53 (49%)	54 (51%)	50 (40%)	75 (60%)

Justifikimi i titujve i zbërthyer në grupmosha


Profesorët që u takojnë grupmoshave më të reja del se janë më të përgjegjshëm në raport me punën akademike. Vetëm 20% e profesorëve nën moshën 40 vjeçare nuk e justifikojnë titullin e tyre akademik, po ashtu 20% të profesorëve mes moshës 40-50 vjeçare nuk e justifikojnë titullin e tyre akademik, ndërsa 57% të profesorëve mbi moshën 50 vjeçare të cilët nuk e justifikojnë titullin e tyre akademik.

JUSTIFIKIMI I TITUJVE AKADEMIKË SIPAS GRUPMOSHËS

Nr.	Fakultetet në Universitetin e Prishtinës	NËN 40		40 DERI 50		Mbi 50		Mungon informacioni	
		✓	✗	✓	✗	✓	✗	✓	✗
1	Fakulteti Ekonomik	0	2	6	5	9	15	2	4
2	Fakulteti Filozofik	8	0	10	1	2	9	6	6
3	Fakulteti i Arkitekturës	0	0	3	0	2	3	0	0
4	Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë	3	0	12	2	6	14	1	2
5	Fakulteti i Edukimit	2	3	6	3	8	11	3	0
6	Fakulteti i Edukimit Fizik dhe i Sportit	1	0	1	1	1	9	0	2
7	Fakulteti i Filologjisë	3	1	14	3	7	16	4	2
8	Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike	2	0	7	0	7	6	0	1
9	Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike	3	0	5	0	10	8	0	1
10	Fakulteti i Mjekësisë	3	0	19	1	34	26	0	13
11	Fakulteti i Ndërtimtarisë	0	0	1	3	4	10	1	0
12	Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore	5	1	19	5	21	13	2	3
13	Fakulteti Juridik	8	2	5	2	4	10	2	8
Totali i zbërthyer në grupmoshë		38 (80%)	9 (20%)	108 (80%)	26 (20%)	115 (43%)	150 (57%)	21 (33%)	42 (67%)


Personi më i ri në moshë me titullin akademik “profesor i rregullt”, pra që ka kontratë permanente të punës, që nuk e justifikon këtë titull, do të pensionohet në vitin 2041. Kjo do të thotë që një fëmijë që sot është 8 vjeç dhe që vendosë të studiojë në UP, nëse supozohet se ndjek të gjitha nivelet e shkollimit me sukses të plotë, ka mundësi që të mentorohet në të gjitha gradat shkencore (Bachelor, Master, Doktoraturë) nga një profesor jomeritor.

PASQYRA AKADEMIKE PËR FAKULTETE





FAKULTETI EKONOMIK



Nga 43 profesorë në Fakultetin Ekonomik, 60% (26) prej tyre nuk e justifikojnë titullin akademik. Nga ata që nuk e justifikojnë titullin e tyre akademik, 8 nga 8 janë profesorë asistentë, krahasuar më 2019 kur ishin 5 nga 8, vitin 2018 që ishin 5 nga 11 dhe në vitin 2017 ishin 6 nga 13 të tillë. 6 profesorë të asocuar nga 17 sa janë gjithsej nuk e justifikojnë titullin akademik, në vitin 2019 ishin 8 nga 20, në vitin 2018 të tillë ishin 10 nga 19, e në 2017 ishin 12 nga 18. Ndërsa, 12 nga 18 profesorët e rregullt nuk e justifikojnë titullin e tyre akademik, krahasuar me 12 nga 16 në 2019, 12 nga 14 në vitin 2018 dhe 13 nga 14 sa ishin në 2017.

JUSTIFIKIMI I TITUJVE NË FAKULTETIN EKONOMIK

Vitet	Profesorët asistentë		Profesorët e asocuar		Profesorët e rregullt		Total	
	✓	✗	✓	✗	✓	✗	✓	✗
2020	0 (0%)	8 (100%)	11 (65%)	6 (35%)	6 (33%)	12 (67%)	17 (40%)	26 (60%)
2019	3 (38%)	5 (63%)	12 (60%)	8 (40%)	4 (25%)	12 (75%)	19 (43%)	25 (57%)
2018	6 (54%)	5 (46%)	9 (47%)	10 (53%)	2 (14%)	12 (86%)	17 (38%)	27 (62%)
2017	7 (54%)	6 (46%)	6 (33%)	12 (67%)	1 (7%)	13 (93%)	14 (31%)	31 (69%)

Vetëm 31% e profesorëve burra e justifikojnë titullin, krahasuar me 57% e profesorëve gra të cilat e justifikojnë titullin e tyre akademik.

JUSTIFIKIMI PËR SECILIN TITULL I ZBËRTHYER NË GJINI NË FAKULTETIN EKONOMIK

	GRA		BURRA	
	✓	✗	✓	✗
Profesor i Rregullt	3	2	3	10
Profesor i Asocuar	5	1	6	5
Profesor Asistent	0	3	0	5
TOTAL	8	6	9	20


Përqindja më e madhe e justifikimit të titujve është te profesorët e moshës nga 40 deri 50 vjeçare.

JUSTIFIKIMI I TITUJVE I ZBËRTHYER NË GRUPMOSHA DHE GJINI NË FAKULTETIN EKONOMIK

	NËN 40		40 DERI 50		Mbi 50		Mungon informacioni		Totali gjini	
	✓	⊖	✓	⊖	✓	⊖	✓	⊖	✓	⊖
Gjinitë	✓	⊖	✓	⊖	✓	⊖	✓	⊖	✓	⊖
Burra	0	2	4	3	3	13	2	2	9 (31%)	20 (69%)
Gra	0	0	2	2	6	2	0	2	8 (57%)	6 (43%)
Totali grupmosha	0 (0%)	2 (100%)	6 (54%)	5 (46%)	9 (37%)	15 (63%)	2 (33%)	4 (67%)	17 (40%)	26 (60%)


Profesorët në këtë fakultet kanë publikuar në total 159 punime në revista shkencore, 126 janë të vlefshme për avancim. Në 2019 ishin evidentuar 121 punime, në 2018 98 punime, ndërkah në 2017 ishin evidentuar 75 punime të tilla.

Publikimi shkencor në Fakultetin Ekonomik



19 profesorë në Fakultetin Ekonomik kanë publikuar 60 punime në revista të dyshimta.

Publikimi në revista të dyshimta në Fakultetin Ekonomik



PUBLIKIMI NË REVISTA TË DYSHIMTA SIPAS GRUPMOSHAVE DHE GJINISË NË FAKULTETIN EKONOMIK

	Nën 40	40 - 50	Mbi 50	Mungon informacioni	Totali sipas gjinisë
Burra	1	0	8	2	11
Gra	0	2	6	0	8
Totali sipas moshës	1	2	14	2	19

Në Fakultetin Ekonomik janë 16 profesorë që nuk kanë asnjë punim shkencor të publikuar.

PROFESORËT PA ASNJË PUNIM SIPAS MOSHËS DHE GJINISË NË FAKULTETIN EKONOMIK

nën 40	40-50	mbi 50	Mungon informacioni	Gra	Burra
2	2	10	2	4	12


Ndërkohë që borxhi akademik i profesorëve që nuk justifikojnë titujt e tyre është 70 punime. Profesorët gra që nuk justifikojnë titujt kanë borxh 11 punime, ndërsa profesorët burra kanë borxh 59.

BORXHI AKADEMIK NË FAKULTETIN EKONOMIK

Titulli akademik	Gra	Burra
Profesor i rregullt	6	43
Profesor i asocuar	2	11
Profesor asistent	3	5
Total sipas gjinisë	11	59
Total punime	70	



FAKULTETI FILOZOFIK



Nga 42 profesorë në Fakultetin Filozofik, 38% (16) prej tyre nuk e justifikojnë titullin akademik. Nga ata që nuk e justifikojnë titullin e tyre akademik, 4 nga 21 janë profesorë asistentë krahasuar me vitin 2019 që ishin 5 nga 21, vitin 2018 që ishin 4 nga 14, dhe në 2017 ishin 5 nga 12 të tillë. 6 profesorë të asocuar nga 12 sa janë gjithsej nuk e justifikojnë titullin akademik, në vitin 2019 dhe 2018 ishin 9 nga 11, e në 2017 ishin 11 nga 12. Ndërsa, 6 nga 8 profesorët e rregullt nuk e justifikojnë titullin e tyre akademik, krahasuar me 8 nga 9 në vitin 2019, 7 nga 7 në vitin 2018 dhe 8 nga 8 sa ishin në 2017.

JUSTIFIKIMI I TITUJVE NË FAKULTETIN FILOZOFIK

Vitet	Profesorët asistentë		Profesorët e asocuar		Profesorët e rregullt		Total	
	✓	✗	✓	✗	✓	✗	✓	✗
2020	18 (82%)	4 (18%)	6 (50%)	6 (50%)	2 (25%)	6 (75%)	26 (62%)	16 (38%)
2019	16 (76%)	5 (24%)	2 (18%)	9 (82%)	1 (11%)	8 (89%)	19 (46%)	22 (54%)
2018	10 (71%)	4 (29%)	2 (18%)	9 (82%)	0 (0%)	7 (100%)	12 (37%)	20 (63%)
2017	7 (58%)	5 (42%)	1 (8%)	11 (92%)	0 (0%)	8 (100%)	8 (25%)	24 (75%)

Vetëm 53% e profesorëve burra e justifikojnë titullin, krahasuar me 90% e profesorëve gra të cilat e justifikojnë titullin e tyre akademik.

JUSTIFIKIMI PËR SECILIN TITULL I ZBËRTHYER NË GJINI NË FAKULTETIN FILOZOFIK

	GRA		BURRA	
	✓	✗	✓	✗
Profesor i Rregullt	0	0	2	6
Profesor i Asocuar	2	0	4	6
Profesor Asistent	7	1	11	3
Total	9	1	17	15


Përqindja më e madhe e justifikimit të titujve është te profesorët nën moshën 40 vjeçare.

JUSTIFIKIMI I TITUJVE I ZBËRTHYER NË GRUPMOSHA DHE GJINI NË FAKULTETIN FILOZOFIK

Gjinitë	NËN 40		40 DERI 50		Mbi 50		Mungon in- formacioni		Total gjini	
	✓	✗	✓	✗	✓	✗	✓	✗	✓	✗
Burra	4	0	9	1	1	9	3	5	17 (53%)	15 (47%)
Gra	4	0	1	0	1	0	3	1	9 (90%)	1 (10%)
Totali grupmosha	8	0	10	1	2	9	6	6	26 (62%)	16 (38%)


Profesorët në këtë fakultet kanë publikuar në total 92 punime në revista shkencore, 90 janë të vlefshme për avancim. Në 2019 ishin evidentuar 50 punime të tilla, në 2018 34 punime të tilla, ndërkaq në 2017 ishin evidentuar 24 punime të tilla.

Publikimi shkencor në Fakultetin Filozofik



7 profesorë në Fakultetin Filozofik kanë publikuar 10 punime në revista të dyshimta.

Publikimi në revista të dyshimta në Fakultetin Filozofik



PUBLIKIMI NË REVISTA TË DYSHIMTA SIPAS GRUPMOSHAVE DHE
GJINISË NË FAKULTETIN FILOZOFIK

	Nën 40	40 - 50	Mbi 50	Mungon informacioni	Totali sipas gjinisë
Burra	0	3	2	0	5
Gra	1	1	0	0	2
Totali sipas moshës	1	4	2	0	7

Në Fakultetin Filozofik janë 13 profesorë që nuk kanë asnjë punim shkencor të publikuar.

PROFESORËT PA ASNJË PUNIM SIPAS MOSHËS DHE GJINISË
NË FAKULTETIN FILOZOFIK

nën 40	40-50	mbi 50	Mungon informacioni	Gra	Burra
0	0	8	5	1	12


Ndërkohë që borxhi akademik i profesorëve që nuk justifikojnë titujt e tyre është 48 punime. Profesoret gra që nuk justifikojnë titujt kanë borxh 1 punim, ndërsa profesorët burra kanë borxh 47.

BORXHI AKADEMIK NË FAKULTETIN FILOZOFIK

Titulli akademik	Gra	Burra
Profesor i rregullt	0	28
Profesor i asocuar	0	16
Profesor asistent	1	3
Total sipas gjinisë	1	47
Total punime		48



FAKULTETI I ARKITEKTURËS



Më 1 tetor 2019, Senati i Universitetit të Prishtinës votoi për themelimin e Fakultetit të veçantë të Arkitekturës. Ky Fakultet ka qenë deri atëherë pjesë e Fakultetit të Ndërtimtarisë [dhe Arkitekturës].

Nga 8 profesorë në Fakultetin e Arkitekturës, 37% (3) prej tyre nuk e justifikojnë titullin akademik. Nga ata që nuk e justifikojnë titullin e tyre akademik janë 1 (nga 1) profesor i rregullt, 1 nga 2 profesorë të asocuar, dhe 1 nga 5 profesorë asistentë.

JUSTIFIKIMI PËR SECILIN TITULL I ZBËRTHYER NË GJINI
NË FAKULTETIN E ARKITEKTURËS

Profesorët asistentë		Profesorët e asocuar		Profesorët e rregullt		Total	
✓	⊖	✓	⊖	✓	⊖	✓	⊖
5 (83%)	1 (17%)	1 (50%)	1 (50%)	0 (0%)	1 (100%)	5 (63%)	3 (37%)

Përqindja më e madhe e justifikimit të titujve është te profesorët nën moshën 40 vjeçare, me 100% të tyre.

JUSTIFIKIMI PËR SECILIN TITULL I ZBËRTHYER NË GJINI
NË FAKULTETIN E ARKITEKTURËS


	GRA		BURRA	
	✓	⊖	✓	⊖
Profesor i Rregullt	0	1	0	0
Profesor i Asocuar	1	1	0	0
Profesor Asistent	4	0	0	1
Total	5	2	0	1

JUSTIFIKIMI I TITUJVE I ZBËRTHYER NË GRUPMOSHA DHE GJINI NË FAKULTETIN E ARKITEKTURËS

Gjinitë	NËN 40		40 DERI 50		Mbi 50		Mungon in- formacioni		Total gjini	
	✓	✗	✓	✗	✓	✗	✓	✗	✓	✗
Burra	0	0	0	0	0	1	0	0	0	1 (100%)
Gra	0	0	3	0	2	2	0	0	5 (71%)	2 (29%)
Totali grupmosha	0	0	3 (100%)	0	2 (40%)	3 (60%)	0	0	5 (62%)	3 (37%)


Profesorët në këtë fakultet kanë publikuar në total 21 punime në revista shkencore, dhe 23 janë të vlefshme për avancim. Kjo nënkupton që në ndonjë punim mund të jenë autor i parë dhe korrespondent dy profesorë nga fakulteti, dhe rrjedhimisht numërohet dy herë sipas rregullativave në fuqi.

Publikimi shkencor në Fakultetin e Arkitekturës



1 profesor në Fakultetin e Arkitekturës ka publikuar 3 punime në revista të dyshimta.

Publikimi në revista të dyshimta në Fakultetin e Arkitekturës



PUBLIKIMI NË REVISTA TË DYSHIMTA SIPAS GRUPMOSHAVE DHE GJINISË NË FAKULTETIN E ARKITEKTURËS

	Nën 40	40 - 50	Mbi 50	Mungon informacioni	Totali sipas gjinisë
Burra	0	0	0	0	0
Gra	0	0	1	0	1
Totali sipas moshës	0	0	1	0	1

Në Fakultetin e Arkitekturës është një profesor që nuk ka asnjë punim shkencor të publikuar.

PROFESORËT PA ASNJË PUNIM SIPAS MOSHËS DHE GJINISË NË FAKULTETIN E ARKITEKTURËS

nën 40	40-50	mbi 50	Mungon in- formacioni	Gra	Burra
0	0	1	0	0	1


Ndërkohë që borxhi akademik i profesorëve që nuk justifikojnë titujt e tyre është 3 punime. Profesorët gra që nuk justifikojnë titujt kanë borxh 2 punime, ndërsa profesorët burra kanë borxh një.

BORXHI AKADEMIK NË FAKULTETIN E ARKITEKTURËS

Titulli akademik	Gra	Burra
Profesor i rregullt	1	0
Profesor i asocuar	1	0
Profesor asistent	0	1
Total sipas gjinisë	2	1
Total punime	3	



FAKULTETI I BUJQËSISË DHE I VETERINARISË



Nga 40 profesorë në Fakultetin e Bujqësisë dhe Veterinarisë, 45% (18) prej tyre nuk e justifikojnë titullin akademik. Nga ata që nuk e justifikojnë titullin e tyre akademik, 3 nga 11 janë profesorë asistentë krahasuar me vitin 2019 që ishin 4 nga 13, dhe 2018 që ishin 1 nga 10. Ndërkaq, në 2017 ishin 2 nga 10 të tillë. 6 profesorë të asocuar nga 13 sa janë gjithsej nuk e justifikojnë titullin akademik, në vitin 2019 ishin 7 nga 12, në vitin 2018 të tillë ishin 7 nga 10, e në 2017 ishin 8 nga 10. Ndërsa, 5 nga 13 profesorët e rregullt nuk e justifikojnë titullin e tyre akademik, krahasuar me 9 nga 13 në vitin 2019, dhe 8 nga 13 sa ishin në 2018 dhe 2017.

JUSTIFIKIMI I TITUJVE NË FAKULTETIN E BUJQËSISË
DHE VETERINARISË

Vitet	Profesorët asistentë		Profesorët e asocuar		Profesorët e rregullt		Total	
	✓	✗	✓	✗	✓	✗	✓	✗
2020	11 (79%)	3 (21%)	6 (46%)	7 (54%)	5 (38%)	8 (62%)	22 (55%)	18 (45%)
2019	9 (69%)	4 (31%)	5 (42%)	7 (58%)	4 (31%)	9 (69%)	18 (47%)	20 (53%)
2018	9 (90%)	1 (10%)	3 (30%)	7 (70%)	5 (38%)	8 (62%)	17 (51%)	16 (49%)
2017	8 (80%)	2 (20%)	2 (20%)	8 (80%)	5 (38%)	8 (62%)	15 (45%)	18 (55%)

55% e profesorëve burra e justifikojnë titullin, krahasuar me 50% e profesorëve gra të cilat e justifikojnë titullin e tyre akademik.

 JUSTIFIKIMI PËR SECILIN TITULL I ZBËRTHYER NË GJINI
NË FAKULTETIN E BUJQËSISË DHE VETERINARISË

	GRA		BURRA	
	✓	✗	✓	✗
Profesor i Rregullt	0	0	5	8
Profesor i Asocuar	0	1	6	6
Profesor Asistent	2	1	9	2
Total	2	2	16	19


Përqindja më e madhe e justifikimit të titujve është te profesorët nën moshën 40 vjeçare, me 100% të tyre.

JUSTIFIKIMI I TITUJVE I ZBËRTHYER NË GRUPMOSHA DHE GJINI NË FAKULTETIN E BUJQËSISË DHE VETERINARISË

Gjinitë	NËN 40		40 DERI 50		Mbi 50		Mungon in- formacioni		Total gjini	
	✓	✗	✓	✗	✓	✗	✓	✗	✓	✗
Burra	2	0	12	1	6	14	0	1	20 (55%)	16 (45%)
Gra	1	0	0	1	0	0	1	1	2 (50%)	2 (50%)
Totali grupmosha	3 (100%)	0 (0%)	12 (85%)	2 (15%)	6 (30%)	14 (70%)	1 (33%)	2 (67%)	22 (55%)	18 (45%)


Profesorët në këtë fakultet kanë publikuar në total 277 punime në revista shkencore, prej tyre 146 janë të vlefshme për avancim. Në 2019 ishin evidentuar 209 punime, në 2018 ishin evidentuar 184 punime të tilla, ndërkohë që në 2017 ishin evidentuar 175 punime të tilla.

Publikimi shkencor në Fakultetin e Bujqësisë dhe Veterinarisë



19 profesorë në Fakultetin e Bujqësisë dhe Veterinarisë kanë publikuar 48 punime në revista të dyshimta.

Publikimi në revista të dyshimta në Fakultetin e Bujqësisë dhe Veterinarisë



PUBLIKIMI NË REVISTA TË DYSHIMTA SIPAS GRUPMOSHËS DHE GJINISË NË FAKULTETIN E BUJQËSISË DHE VETERINARISË

	Nën 40	40 - 50	Mbi 50	Mungon informacioni	Totali sipas gjinisë
Burra	1	6	9	1	17
Gra	1	0	0	1	2
Totali sipas moshës	2	6	9	2	19

Në Fakultetin e Bujqësisë dhe Veterinarisë janë 10 profesorë që nuk kanë asnjë punim shkencor të publikuar.

PROFESORËT PA ASNJË PUNIM SIPAS MOSHËS DHE GJINISË NË FAKULTETIN E BUJQËSISË DHE VETERINARISË

nën 40	40-50	mbi 50	Mungon informacioni	Gra	Burra
0	2	6	2	2	8


